



# Procesi i Ligj-bërjes në Kosovë

*Data: 23 maj 2019*

*Vendi: Shoqata e Bankave të Kosovës*

## OBJEKTIVAT

Qëllimi i trajnimit është prezantimi me kornizën ligjore dhe institucionale në procesin e hartimit dhe koordinimit të politike dhe të ligj-bërjes në Kosovë. Pjesëmarrësit në trajnim do të kenë mundësi të informohen dhe mësojnë për fazat e procesit të hartimit dhe miratimit të ligjeve dhe për rolin e institucioneve dhe zyrtarëve në këtë proces.

## METODOLOGJIA

Nga temat që do të prezantohen dhe shembujt që do të ilustrohen, pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të reja për mundësinë e përcjelljes së procesit të hartimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe mundësinë e ndikimit gjatë hartimit dhe shqyrtimit të këtyre akteve në nivelin ekzekutiv dhe legjislativ, përmes dhënies së komenteve dhe rekomandimeve, veçanërisht kur një projektligj apo nënligjor rregullon fushën e sektorit bankar dhe financiar në përgjithësi.

## KUSH DUHET TË MARRË PJESË

Departamentet ligjore, zyrtarët e pajtueshmërisë të institucioneve financiare si dhe të gjithë të tjerët që janë të interesuar që të kenë më shumë njohuri në procesin e ligj-bërjes në Kosovë.

## LIGJERUESI

**Z. Vilson Ukaj** - Koordinator i Komisionit për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Departamentit për çështje ligjore dhe procedurale të Administratës së Kuvendit

Z. Ukaj ka përfunduar studimet Baçelor i Drejtësisë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku po ashtu në këtë universitet ka kryer studimet Master, Drejtimi Juridik-Financiar. Ndërsa, në vitin 2013, ka mbaruar studimet Master në Menaxhimin Publik në Universitetin "Hertie School of Governance", në Berlin të Gjermanisë.

Që nga viti 2007, z. Ukaj është i punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, fillimisht në pozitën e zyrtarit ligjor dhe që nga viti 2011 në pozitën e koordinаторit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Departamentit për çështje ligjore dhe procedurale të Administratës së Kuvendit.

# Procesi i Ligj-bërjes në Kosovë

Data: 23 maj 2019

Vendi: Shoqata e Bankave të Kosovës

Z. Ukaj, ka kryer një numër trajnimesh brenda dhe jashtë vendimit, me temat në fushën e hartimit dhe teknikave të legjislacionit, për legjislacionin dhe institucionet e BE-së, për mbikëqyrjen parlamentar të legjislacionit, në fushën e buxhetimit, raportimit financiar dhe financave publike në përgjithësi.

Po ashtu z. Ukaj, ka realizuar disa vizita studimore dhe pjesëmarrje në Konferenca dhe programe trajnuese, në vende të ndryshme të rajonit, BE-së dhe në SHBA. Në kuadër të kësaj, ka përfunduar trajnimin elektronik në dy cikle, me temë "Parlamenti dhe Buxheti I dhe II", në vitin 2015, të organizuar nga Banka Botërore dhe trajnimin Matra Rule of Law Training Programme, me temë "Menaxhimi i Financave Publike", organizuar nga konzorciumi Shkolla për Drejtësi Leiden, Komiteti Helsinki i Holandës dhe Akademia e Hagës për Qeverisje Lokale, në Hagë dhe Leiden -Holandë, me datë 5-16 qershor 2018.

## AGJENDA

09:15-09:30	Regjistrimi i pjesëmarrësve	13:00-14:00	Procesi legjislativ në Kuvend
09:30-09:45	Procesi Ligj-Bërjes (Përmbledhje)	14:00-14:15	Roli i Presidentit në procesin legjislativ
09:45-10:00	Korniza Ligjore në Procesin e Hartimit të Politikave dhe Legjislacionit	14:15-14:30	Pauzë për Kafë
10:00-10:15	Fazat e Procesit Legjislativ	14:30 -15:00	Sfidimi i Ligjeve në Gjykatën Kushtetuese
10:15-10:30	Pauzë për Kafë	15:00-15:15	Roli i Shoqërisë Civile dhe Grupeve të Interesit në procesin e hartimit të legjislacionit me interes të veçantë
10:30-10:45	Institucionet dhe roli i tyre në procesin ligj-bërjes	15:15-15:30	Përfundim dhe shpërndarja e Certifikatave
10:45 -12:00	Procesi legjislativ në Qeveri		
12:00-13:00	Dreka		

## REGJISTRIMI

Ju lutem të na dërgoni formën e regjistrimit në SHBK në email adresën: [kbatrainingcenter@bankassoc-kos.com](mailto:kbatrainingcenter@bankassoc-kos.com) ose **038 246 171**

**Pjesëmarrja është pa pagesë**